

L I G J
Nr. 8606, datë 27.4.2000

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8081, DATË 7.3.1996 “PËR
VEPRIMTARITË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT”, NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR.8458, DATË 11.2.1999**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet të kenë një kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, jo më të vogël se shumatat e përcaktuara sipas grupeve të sigurimit:

- a) 100 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 10 deri në 15 (përfshirë grupin 15) të shtojcës së këtij ligji;
- b) 60 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 1 deri në 8 (përfshirë grupin 8) dhe 16 e 18 të shtojcës së këtij ligji;
- c) 50 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 9 dhe/ose 17 të shtojcës së këtij ligji;
- ç) 120 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë për sigurimin e jetës në një ose më shumë prej grupeve 19 deri 22 (përfshirë grupin 22).

Kapitali themeltar i shoqërisë së sigurimit duhet të përbëhet, të paktën në dy të tretat e tij, prej mjeteve monetare. Çdo aksioner duhet të derdhë për llogari të shoqërisë, në krijim e sipër, në njërën nga bankat tregtare të nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në mjete monetare jo më pak se gjysmën e kontributit të nënshkruar prej tij.”

Neni 2

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

“Shoqëritë, të cilat janë pajisur me autorizim zyrtar për ushtrimin e veprimtarisë siguroese dhe/ose risiguroese, brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të arrijnë kufijtë e kapitalit themeltar, të përcaktuar në nenin 23, si vijon:

- a) 50 milionë lekë në fund të vitit të parë;
- b) 60 milionë lekë në fund të vitit të dytë;
- c) 100 milionë lekë në fund të vitit të tretë.”

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 28 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 33, pas pikës 5, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Të japë informacion për origjinën e kapitalit. Për origjinën e kapitalit Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka të drejtë të kërkojë të dhëna nga autoritetet përgjegjëse të shtetit të

originës.”

Neni 5

Shkronja “a” e nenit 65 ndryshohet si vijon:

“a) të jenë të pajisura me zotësinë për të kryer operacione sigurimi, në mbështetje të legjislacionit të shtetit të originës dhe të kenë ushtruar veprimtari të paktën prej 5 vjetësh.”

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2617, datë 11.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.